



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 19.06.2025

Numër Protokolli: 5046/2025

A.nr.359/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës nën shenjë A.nr.359/2024 të datës 25.02.2025 të parashtruar nga ankuesja A.Sh, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.395/2025, e datës 25.02.2025 e parashtruar nga ankuesja, A.Sh.

II. Anulohet Njoftimi lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, i datës 28.01.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00015897, për “Grupin e Burimeve Njerëzore”, pozita e punës Zyrtar i Personelit.

III. Mbetët në fuqi akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00015897, për “Grupin e Burimeve Njerëzore”, pozita e punës Zyrtar i Personelit, i publikuar me datë 27.11.2024 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, **ndërsa, çështja kthehet** në fazën e vlerësimit të aplikacioneve.

IV. Obligohet Menaxheri i Personelit në Shërbimi Korrektues i Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II dhe III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ankuesja, A.Sh ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër referencës RN00015897, për Grupin Burimeve Njerzore, gjegjësisht për pozitën “Zyrtar i Personelit” Klasa Profesional 2 i shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.03.2025 ka proceduar kërkesat për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 25.03.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 1209/2025 të datës 25.02.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00015897, të datës 25.01.2025.; kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Listën e aplikanteve; Listën e refuzuar dhe të aprovuar; Njoftimin e datës 08.01.2025; Vendimin e datës 08.01.2025 për themelimin e komisionit pranimit; Kopjen Aplikacionit të kandidatës fituese M.Z e datës 03.12.2025 të bashkangjitur me dokumentet e aplikimit; Akt emërimit të anëtarëve të komisionit; kopjen e aplikacionit të ankuese A.Sh e datës së aplikimit 26.12.2025 të bashkangjitur me dokumentet e aplikimit; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 28.01.2025; Njoftimi për kandidaten fituese të datës 28.01.2025;

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankueses **janë të bazuara, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 27.11.2024, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015897, për “Grupin e burimeve njerëzore”, gjegjësisht për pozitën *Zyrtar i personelit*, klasa Profesional 2, një (1) vend pune, me afat të aplikimit nga data 28.11.2024 deri më 27.12.2024.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 69 kandidatë, ndërsa prej tyre 42 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesen, e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit duke arritur gjithsejtë 70 pikë të përgjithshme.

Organi përkatës i punësimit, me datë 28.01.2025, ka publikuar Njoftimin lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja M.Z me gjithsejtë 81 pikë të arritura, është shpallur kandidat fitues për pozitën e punës „Zyrtar i Personelit”.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përzgjedhja përfundimtare e kandidatës fituese nga Komisioni i Pranimit, është bërë në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore, duke mos respektuar kriteret sipas shpalljes publike, në mënyrë absolute dhe jo meritore si dhe me ndikim të drejtpërdrejtë politik, duke theksuar ndër të tjera se procedura e rekrutimit është zhvilluar me shkelje procedurale dhe ligjore duke diskriminuar kandidatët potencial dhe meritore, nuk janë publikuar pikët e testit, intervistës si dhe pikët e përgjithshme të kandidatëve në listën fituese. Andaj, ankuesja kërkon aprovimin e ankesës si të bazuar dhe anulimin e konkursit me numër reference RN00015897.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit publik me numër reference RN00015897, për “Grupin e Burimeve Njerzore”, gjegjësisht për pozitën Zyrtar i Personelit dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në drejtimet: Juridik, Ekonomi, Psikologji, Administratë Publike, Pedagogji, Menaxhim i Burimeve Njerzore; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale.**

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Ndërsa, sipas nën pikës 2 të pikës 5 të konkursit të datës 27.11.2024, rezulton se gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, ku është përcaktuar se: *Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, kërkesat e përgjithshme formale të lartë theksuar si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor se përzgjedhja përfundimtare e kandidates fituese nga Komisioni i Pranimit, është bërë në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore, duke mos respektuar kriteret sipas shpalljes publike, është i drejtë dhe i bazuar, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, sipas konkursit të shpallur me numër reference RN00015897, për pozitën përkatëse është kërkuar që kandidatët të kenë **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Juridik, Ekonomi, Psikologji, Administratë Publike, Pedagogji, Menaxhim i Burimeve Njerzore** si dhe **së paku një (1) vite përvojë pune profesionale**, ndërsa, nga analizimi i dosjes së datës 03.12.2024, të kandidates të suksesshme M.Z, Kolegji ka gjetur se e njëjta nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit përkatës, ngase e njëjta me rastin e aplikimit ka bashkëngjitur Diplomën me Nr. 7974 të lëshuar me datë 03.10.2022, nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se me datë 27.09.2022, e njëjta ka përfunduar studimet themelore universitare në Fakultetin Filozofik, në Departamentin e Shkencave Politike- Programi Shkenca Politike dhe ka marr titullin Bachelor i Shkencave Politike,

nga rezulton se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin arsimor ashtu siç është kërkuar me shpalljen e konkursit.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve që plotësojnë kriteret e konkursit, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës *Zyrtar i personelit*, ka përfshirë në listë të ngushtë edhe kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, dhe se e njëjta është shpallur edhe kandidatë fituese, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve; 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi*, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.

Kështu që, për sa me sipër dhe më qëllim të kthimit të ligjshmërisë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit, Kolegji i Këshillit vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, anulimin e Njoftimit lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, të datës 28.01.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional. Ndërsa, meqenëse konkursi nuk është përfshirë me shkelje ligjore, Kolegji la në fuqi të njëjtin, ***ndërsa çështja kthehet*** në fazën e vlerësimit të aplikacioneve, rrjedhimisht obligohet Menaxheri i Personelit të Shërbimi Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë të punës dhe në listën e ngushtë të përfshihen vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet formale sipas konkursit.

Thënë si me sipër, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.359/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.Sh;
- Menaxherit të Personelit të Shërbimi Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.